



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

Nr. 3626 Prot.

Tiranë, më 17.12.2025

V E N D I M

Nr. 83 datë. 17.12.2025

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT,
SHPLLUR NË DATËN 27.05.2024.**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit” dhe nenit 14, pika 7 të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, referuar totalit të pikëve maksimale të secilit kandidat bazuar në vendimet e vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidaturave për vendet vakant për inspektor jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për plotësimin e vendit vakant për inspektor Jomagjistrat, shpallur në datën 27.05.2024, pasi asnjë nga kandidatët nuk ka siguruar mbi 70% (për qind) të totalit të pikëve maksimale.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rubrikën “Njoftime”, nën rubrika “Rekrutim Jo-Magjistrat”.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

Lindita Ziguri

KRYETAR

Elena Pelushi

ANËTAR

Joana Sorraj

